



### KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Në Tiranë, sot më datën 18.07.2006 (dy mijë e gjashtë), në Dhomën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Shpresa Kurti, ndërmjet:

- a) **Stavros Papageorgiou**, i biri i Nikolaos dhe Vasilikis, biznesmen, lindur në Tropaia, Arkadias, Greqi më 1931, banues në Kifissias Attikis, Har. Trikoupi Str 77, Greqi, mbajtës i pasaportës greke Nr. Π317397/11.05.1990, (në vazhdim quajtur "Shitësi"), përfaqësuar këtu nga z. Andon Kokoli, mbajtës i letërnjoftimit NF Nr. 489724, në bazë të Prokurës Nr. 48.022/22.05.2006 të redaktuar nga Noteri Publik z. Nikolaos H. Stasinopoulos – Akadimias 81, Athinë.
- b) **Shoqërisë anonime "PIRAEUS BANK SA"**, shoqëri e organizuar dhe që vepron sipas ligjeve greke, me seli në Athinë (4 Amerikis Str.), regjistruar rregullisht në Regjistrin e Shoqërive Aksionere mbajtur nga Ministria e Tregtisë me Nr.6065/06/B/86/04 (në vazhdim quajtur "Blerësi"), përfaqësuar ligjërisht në këtë kontratë nga z. Dimitrios Fraggetis, shtetas grek, mbajtës i pasaportës greke Nr. O 253968, në bazë të Prokurës Nr. 7.773/12.05.2006 redaktuar nga Noteri Publik z. Stefanos K. Vasilakis – 21 Vas. Georgiou I<sup>t</sup>, Pire.

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

- 1. Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të dy mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë (2.358) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind e tridhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë (139,87) USD secili. Këto aksione përfaqësojnë 2% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të Liçensës së Veprimit Nr.07/12.09.1996 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Për këto aksione është lëshuar një certifikatë aksioni provizore (Nr.3, datë 27.06.2006).
- 2. Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të të gjitha aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të dy mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë (2.358) aksioneve të regjistruara me një vlerë nominale prej një qind e tridhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë (139,87) USD secili, që përfaqësojnë 2% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime "BANKA e TIRANËS", me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre, **Blerësit** i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej gjashtëqind e dyzetë mijë (640.000) EUR. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të BANKA e TIRANËS.
- 3. Blerësi** ia ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej gjashtëqind e dyzetë mijë (640.000) EUR.

4. **Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
5. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.
6. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë dhe ai do të marrë nga BANKA e TIRANËS certifikatat përfundimtare të aksioneve kur ato të lëshohen.
7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.
8. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.


Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë ekzekutohet në gjashtë origjinale konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë në prezencë të përkthyeses të gjuhës greke znj. Eva ÇAMI, e bija e Dhimitrit, lindur më 06.09.1971 në Tiranë dhe banuese po aty, mbajtëse e pasaportës Nr.0483795 dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

#### PALET KONTRAKTUESE

##### SHITËSI

**Stavros Papageorgiou**


Përfaqësuar me Prokurë nga

  
Ardon Koxoli

##### BLERËSI


**“PIRAEUS BANK SA”**


Përfaqësuar me Prokurë nga

  
D. FRANGETIS

**Përkthyesë:**

**Eva ÇAMI**



  
Noterë  
Gjiroçenë Kurti